



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:266291  
Datë: 24.01.2025  
Numri i dokumentit: 06755851

ARJ.nr.150/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Delushe Halimi kryetare, Ragip Namani dhe Beshir Islami anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “M. C.” shpk, me seli në P., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners”, me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK), me seli në Prishtinë, me bazë juridike anulim i aktit administrativ - vendimit të paditurës nr.01.3.2.2/2539 të datës 03.03.2021, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, të paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.935/22, të datës 06.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22 janar 2025, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar nga paditësi “M. C.” shpk, me seli në P., kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.935/22, të datës 06.11.2023.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.935/22, të datës 06.11.2023, është vendosur si në vijim: REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit “Mili Company” Sh.P.K me seli në P., ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1475/19, të datës 16.02.2021, VËRTETOHET.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.935/22, të datës 06.11.2023, paditësi përmes të autorizuarit të tij, në afat ligjor në këtë gjykatë parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës dhe shkeljes të së drejtës materiale, me propozim që të: APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe të ANULOHET Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Dytë K.DH.SH.II.nr.935/22, të datës 06.11.2023, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje

Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1475/19, të datës 16.02.2021, dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor nuk ka ushtruar pala e paditur.

Gjykata Supreme, në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të atakuar, dhe atij të shkallës së parë, sipas kërkesës së paditësit dhe shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e të paditurës Dogana e Kosovës, nr.01.3.2.2/2539 të datës 03.03.2021, është refuzuar si e pa bazuar kërkesa e subjektit në procedurë për rishqyrtimin e vendimit DUD-ave R-2., 1., 20.03.2019, R2., 09.03.2019, R4., 23.04.2019, R4., 24.04.2019, R4., 01.05.2019 të ZBD P.. 3, dhe R9., 01.04.2019 të ZD H. i E. T. Në arsyetim të këtij vendimi ndër të tjera theksohet se: Vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nga ankuesi, këtu paditësi, nuk është çmim real i paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë, për arsye se është deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera e paguar apo që ka për tu paguar për mallin e shitur për eksport, përkatësisht për import në vështrim të nenit 33, të KDAK-së, andaj Dogana ka vendosur që vlera doganore të caktohet në bazë të metodës së 6 (gjashtë) të vlerësimit në vështrim të nenit 35, të këtij kodi. Ndërsa, dokumentacioni përcjellës i mallit është konsideruar i pamjaftueshëm me arsyetimin se mungon deklarata eksportuese dhe transferet bankare përkatësisht pagesa në emër të faturës.

Kundër vendimit të lartë cekur të paditurës Dogana e Kosovës, paditësi me padi fillon konflikt administrativ.

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin, A.nr.1475/19, të datës 16.02.2021, ka vendosur si në vijim: REFUZOHET Kërkesëpadija e paditësit M. C. Sh.p.k, me seli në P., si e pa bazuar. Mbetet në fuqi Aktvendimi nr.01.3.2.2/2539, të datës 03.03.2021, i Doganës së Kosovës në Prishtinë.

Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj arsyeton ndër të tjera se: Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se as në këtë konflikt administrativ, paditësi nuk ka qenë në gjendje që gjykatës t'ia dëshmoj provat për të vërtetuar se vlera e mallit lëndor është vlerë e vërtet e transaksionit e paguar për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, siç parashihet me dispozitat e nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr. 03/L-109. Përkundrejt pretendimeve të paditësit në padi dhe në seancën e shqyrtimit kryesor se të gjitha dokumentet janë të harmonizuara në kuptim të vlerës së transaksionit të kryer për mallin e blerë gjykata konstaton se dokumentacioni për mallin lëndor i paraqitur në procedurën administrative dhe në këtë konflikt administrativ është i pamjaftueshëm për të konstatuar se vërtet paditësi ka paguar vlerën reale të mallit lëndor. Andaj, gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 81.I par.2 pika 2.1 të Ligjit nr.04/L-102 për ndryshimin dhe

plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Komerciale-Dhomat e shkallës së dytë, me aktgjykimin e kontestuar me kërkesë, duke vendosur sipas ankesës së palës paditëse në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA)-së, nenit 81.H të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222 dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK)-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj si më lartë. Në arsyetim pasi bën përshkrimin e gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, bazuar në shkaqet dhe arsyet po ashtu të njëjta, qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e pranon në tërësi si të drejtë dhe ligjor, duke vlerësuar se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe drejtë është aplikuar e drejta materiale me refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit.

Në arsyetim të aktgjykimit të saj ndër të tjera thekson se: Kolegji gjen se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar drejtë ligjshmërinë e aktit përfundimtar -aktvendimit të Doganës së Kosovës, të atakuar nga paditësi si në vështrim të nenit 9 dhe 44 të LKA-së, me të cilin aktvendim në procedurë administrative e gjithashtu edhe në procedurë gjyqësore sipas aktgjykimit të atakuar me ankesë, në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike, se paditësi nuk ka dëshmuar me dokumentacion adekuat dhe bindës për tu dëshmuar vlera reale e paguar për mallin lëndor, dhe për tu bërë zhdoganimi sipas DUD-ave të lartcekur me metodën e parë (neni 33 të KDA). Nga Dogana e Kosovës i është kontestuar vlera e deklaruar e mallit për zhdoganim, pasi që paditësi nuk ka mundur të argumentoj me prova konkrete mënyrën e pagesës për blerjen e mallit lëndor, dhe në këtë drejtim gjykata nuk ka mundur të pranoj pretendimet në kërkesëpadinë e paditësit. Kolegji njëjtë si gjykata e shkallës së parë, vlerëson se Dogana e Kosovës, bazuar në faktet e cekura si më lartë me të drejtë ka aplikuar metodën e 6 (gjashtë) të vlerësimit, neni 35 i KDA-së, në bazë të dhënave të disponueshme të Doganës për mallin e njëjtë, është bërë përcaktimi i çmimit real të zhdoganimit, e jo ai i deklaruar nga subjekti me çmim me të ulët, sipas dokumenteve përcjellëse të mallit.

Në vazhdim ka theksuar se: pretendimet ankimore të ankuesit se nuk janë analizuar dokumentet e bashkangjitura deklaratës doganore faturën dhe pagesën bankare e cila përputhet me vlerën e faturave përkatësisht të DUD-ave kontestues, kolegji i refuzon si të pa bazuara dhe jo me ndikim për vendosjen e çështjes në mënyrë tjetër, nga ajo që është vendosur në gjykatën e shkallës së parë, sepse Dhomat e Shkallës së Dytë njëjtë sikur edhe gjykata në shkallë të parë, në shkresat e lëndës të paraqitura nga paditësi ka gjetur se për të pranuar vlerën e paguar të transaksionit sipas metodës së parë të vlerësimit, nga neni 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 031-109, në këtë rast paditësi është dashur të dëshmoj vlerën e vërtet të transaksionit të cilën ia ka paguar shitësit-eksportuesit të mallit lëndor “E.., D.. 2.”-B., dhe A. B. T. E.-E. e B. A.. Pala paditëse gjatë procedurës administrative të ankesave nuk ka prezantuar tek e paditura transferet bankare për mallin lëndor të deklaruar me DUD-at kontestues R-2..., 23,03,2019, 1.., 20,03 2019, 1..,09,13,2019, R4.., 23.04.2019, 1.., 24,042019, 1.., 01.05.2019 të Z.. P., 3 dhe R-9.., 01.04.2019 të Z. H. i E. T., ndërsa në procedurën e konfliktit administrativ e autorizuar e palës paditëse, paraqet në seancën gjyqësore transferin ndërkombëtar të datës 24.01.2020, e cila pagesë është

realizuar pas zhdoganimit të mallrave, dhe e njëjta pagesë nuk është e harmonizuar me vlerën e faturave të mallrave lëndore ku me këtë nuk ka mundur të vërtetoj se është bërë pagesa për faturat e mallit doganor e që do të dëshmonte vlerën e transaksionit konform nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109 dhe nga të cilat dokumente do të mund të konstatohet se paditësi ka paraqitur dokumentacion të kompletuar dhe të harmonizuar në bazë të nenit 123 të UA 11/2009.

Andaj, në kuptim të dispozitave nga neni 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata Supreme duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes si më lartë, vlerësimit të pretendimeve si në kërkesë, ekzaminimit të aktgjykimit të kontestuar dhe të shkallës së parë si dhe shkresave tjera të lëndës, vlerëson se dhomat e shkallës së dytë kanë vendosur drejtë dhe në baza ligjore me refuzimin e ankesës së paditësit dhe vërtetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Qëndrimin juridik të Gjykatës Komerciale por edhe të Gjykatës Themelore, në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë meqë aktgjykimet e kontestuara nuk janë të përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës apo të drejtës materiale, ashtu si pretendon pala paditëse në kërkesën e tij. Aktgjykimet e kontestuara përmbajnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje, nga çka rezulton se drejtë është vërtetuar gjendja faktike me refuzimin si të pa bazuar të kërkesëpadisë së paditësit.

Bazuar në provat e administruara për mes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve, nga gjykatat e instancës më të ulët, ka rezultuar se vendimi i të paditurës Dogana e Kosovës, nr.01.3.2.2/2539 të datës 03.03.2021, me të cilin është refuzuar si e pa bazuar kërkesa e subjektit në procedurë për rishqyrtimin e vendimit DUD-ave kontestues, është vendim i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga dispozitat ligjore të aplikuara në këtë rast nga gjykatat e instancave më të ulëta, edhe kjo gjykatë vlerëson se Kodi Doganor dhe i Akcizave, në nenin 35 par.1, në mënyrë të qartë ka përcaktuar se: kur vlera doganore e mallrave të importuara nuk mund të përcaktohet në bazë të nenit 33 ose 34, do të përcaktohet në bazën e të dhënave të disponueshme në Kosovë, duke përdorë metoda të arsyeshme në përputhje me parimet dhe dispozitat e përgjithshme.

Pretendimet e paditësit, të theksuara si në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, lidhur me mos zbatimin e dispozitave procedurale nga e paditura, përkatësisht nenin 92 të UA 11/2009, kolegji i Gjykatës Supreme, i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i refuzoi në tërësi si të pabazuara. Gjykata rikujton se neni 123 paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ nr. 11/2009, i liston dokumentet që duhet bashkëngjitur deklaratës doganore. Në rastin konkret, rezulton se paditësi, me rastin e zhdoganimit të mallit lëndorë dhe as përgjatë procedurës administrative të filluar sipas ankesës së tij, nuk ka prezantuar tek e paditura transferet bankare për mallin lëndor të deklaruar sipas DUD-ve kontestues. Nuk është kontestuese që parashtruesi i kërkesës, në procedurën e konfliktit administrativ, pranë gjykatës së shkallës së parë, ka parashtruar si provë: transaksionin ndërkombëtar bankar (pagesën), të datës 24 janar 2020, mirëpo gjykatat e instancave më të ulëta drejt kanë konstatuar dhe vlerësuar

se kjo pagesë, e cila është realizuar pas zhdoganimit të mallrave, nuk është e harmonizuar me vlerën e faturave të mallrave lëndore. Edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate, paditësi as pranë organit të administratës dhe as pranë gjykatës, nuk ka arritur që të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar me vendimin kontestues, dhe nga dëshmitë e parashtruara nuk mund të vërtetohet vlera reale e mallit të zhdoganuar.

Gjykata shqyrtoj edhe pretendimet e tjera të parashtruesit të kërkesës, dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për shkelje të dispozitave të procedurës apo zbatim të gabuar të së drejtës materiale, vlerësoj se këto pretendime janë shqyrtuar nga gjykatat e instancave më të ulëta, të njëjtat janë të pabazuara, të paqëndrueshme dhe të pa argumentuara, për një vendosje ndryshe në këtë çështje nga çka kanë vendosur gjykatat e instancave më të ulëta. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykatat e instancave më të ulëta kanë vepruar në baza ligjore me vendosjen e çështjes, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë, i vërtetuar në procedurë ankimore nga gjykata e shkallës së dytë.

Nga gjendja si më lartë rezulton se gjykatat e instancave më të ulëta në mënyrë të drejtë kanë bërë aplikimin e dispozitave të LKA, LPK, KDAK-së. Aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta janë të qartë të kuptueshëm dhe përmbajnë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, dhe me të drejtë kanë vlerësuar se nuk është cënuar ligji në dëm të paditësit.

Nga se u theksua si më lartë, e në bazë të nenit 54 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME - PRISHTINË  
ARJ.nr.150/2024, më datë 22 janar 2025

B. Profesionale  
Zanë Buçinca

Kryetare e Kolegjit  
Delushe Halimi